



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:011546

Datë: 04.06.2018

Numri i dokumentit: 00052577

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNO-SNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr.2695/17

Në
Data 03. 10. 2018 NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal me gjyqtarin individual Elmaz Zenuni dhe me zyrtarin ligjorë Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit: [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Vitisë për shkak të veprës penale në vazhdim vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, sipas aktit akuzues-Propzimit për shqiptimin e masës edukuese të PTH-së në Gjilan PPM nr.120/2016 të dt. 15.07.2016 të zëvendësuar në aktakuzë në shqyrtim fillestar gjyqësor nga ana e prokurorit të shtetit të PTH-së në Ferizaj, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor të mbajtur me datë 31.05.2018 në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit, ndërsa i përpiuar me 04.06.2018, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Vitisë i lindur më [REDAKTUAR] në fshatin [REDAKTUAR] Komuna e Vitisë nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR], e vajzërisë [REDAKTUAR] me vendbanim në fshati [REDAKTUAR] Komuna e Vitisë, i /pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë-bari, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.personal [REDAKTUAR]

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

- I. me datën 21.01.2016 rreth orës 17:00 në Rrugën "Tahir Sinani" në Ferizaj në xhaminë e madhe, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja për vete apo tjetrin në mënyrë të kundërligjshme kryen vjedhje në dëmin e të dëmtuarit [REDAKTUAR], në atë mënyrë që gjatë kryerjes së riteve fetare ka hyrë në xhami ku nga aty merr këpucët –matrinkat, me ç,rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në lartësi të pa përcaktuar,-

- II. Sepse me datën 08.03.2016 rreth orës 20:00 në Rrugën "Tahir Sinani" në Ferizaj në xhaminë e madhe së bashku me të miturin [REDAKTUAR], me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja për vete apo tjetrin në mënyrë të kundërligjshme kryen vjedhje në dëmin e të dëmtuarve: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në atë mënyrë që gjatë kryerjes së riteve fetare ka hyrë në xhami ku nga aty merr këpucët –pumat, me ç,rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në lartësi të pa përcaktuar,-

- III. Sepse me datën 21.10.2015 rreth orës 19:40 në Rrugën "Tahir Sinani" në Ferizaj në xhaminë e madhe ,me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja për vete apo tjetrin në mënyrë të kundërligjshme kryen vjedhje në dëmin e të dëmtuarve: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në atë mënyrë që gjatë kryerjes së riteve fetare ka hyrë në xhami ku nga aty merr këpucët –ngjyrë të zezë, me ç,rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në lartësi të pa përcaktuar,-

- IV. Sepse me datën 01.12.2016 rreth orës 18:00 në Rrugën "Tahir Sinani" në Ferizaj në xhaminë e madhe, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja për vete apo tjetrin në mënyrë të kundërligjshme kryen vjedhje në dëmin e të dëmtuarit [REDAKTUAR] në atë mënyrë që gjatë kryerjes së riteve fetare ka hyrë në xhami ku nga aty merr këpucët –matrinkat, me ç,rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në lartësi të pa përcaktuar,-

Me të cilën në vazhdim ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Në bazë të dispozitës së lartshënuar neni 325 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe neneve: 4,7,17,21, 41, 42, 43, 48,73, 74 të KPRK-së, si dhe neni 365 te KPPRK-së.

G J Y K O N

- o TË PANDEHURIN [REDAKTUAR] ME DËNIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 3 /tre/ Muaj, si dhe denimi me gjobë në shumën prej 200 eurove, (me shkronja (dyqind euro), në mbështetje të nenit 48 par. 1 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burg dhe me gjobë me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet: në punë në dobi të përgjithshme prej 200 orëve të cilin do ta kryej në afat prej 6 muaj, prej ditës së fillimit të ekzekutimit të aktgjykimit.
- o Konform nenit 48 par. 2 të KPRK-së, Shërbimi Sprovues i Kosovës në Prishtinë, cakton llojin e punës që duhet të kryej personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditën, javën që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme shoqërore si dhe mbikëqyrjen e punës në dobi të përgjithshme shoqërore.
- o Në mbështetje të nenit 48 par. 4 të KPRK-së, nëse personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata do të urdhëroj zbatimin e dënimit të shqiptuar sipas këtij aktgjykimi në përpjesëtim me punën e kryer.
- o Të dëmtuarit dhe ate: 1. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR]” pa nr., 2. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Vitisë, 3. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR]” nr. [REDAKTUAR] 4. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., 5. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., 6. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., 7. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., 8. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Vitisë 9. [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, dhe 10. [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR]” nr. [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike, kompensimi i dëmit udhëzohen në kontest civil.

- Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzet/ € në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit – Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhun.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Gjian –Departamenti për të Mitur sipas Aktvendimit për përgatitjen e procedurës përgatitore PPM nr.120/2016 dt. 07.07.2016, ka inicuar procedurën penale për të miturit [REDACTED] dhe [REDACTED] për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhja nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ka bërë Propozimin për shqiptimin e masës edukuese mbikqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë sipas Propozimit PP nr.120/2016 dt.15.07.2016.

Gjykata Themelore në Gjiilan me Aktvendimin e vet PM nr.90/2016 dt.28.04.2017 është shpallur jokopmetente në pikpamje territoriale dhe lëndën e ka dërgaur për vendosje në GJTH në Ferizaj në Departamentin për të mitur të Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Departamenti për të mitur i Gjykatës Themelore në Ferizaj me shkresën e vetë PM nr. 92/2017 dt. 07.07.2017 ka dërguar lëndën për vendosje në Departamentin e Përgjithshëm në GJTH në Ferizaj për të pandehurin [REDACTED] pasi që është konstatuar se i pandehuri [REDACTED] ka lindur me datën [REDACTED] 1997 dhe në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë madhor.

Gjykata duke vepruar sipas këtij akti akuzues caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 31.05.2018, ku mori pjesë prokurori i shtetit Valdet Avdiu, ku i njehti konform nenit 240

të KPPRK-së, Propozimin e masës edukuese për të pandehurin [REDACTED] e shëndrroj në aktakuzë, me të njejtën përmbajtje sipas aktvendimit për pregatitjen e procedurës pregatitore të PTH –së në Gjilan PPM nr.120/2016 të dt.07.07.2016 për veprat penale vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, të cilën për të pandehurin [REDACTED] e ricilësoi në veprën penale vjedhja në vazhdim nga neni 325 par. 1 të KPRK-së si vepër penale në vazhdim nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe i propozoj gjykatës që për të pandehurin [REDACTED] të shqiptohet një denim i vetëm.

Në shqyrtimin fillestar i pandehuri [REDACTED] është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, duke shtuar se: është i penduar për këto vepra penale, i prmeton gjykatës se në të ardhmen kurr nuk do të kryej vepra penale, i është kthyer punës si bari në fshat është i gjendjes skajshmërisht të varfër me 9 anëtarë familje e të pa punë. Njëherit, i ka propozuar gjykatës që me rasti e denimit ti ket parasysh këto rrethana lehtësuese, e njashtu me plqinin tim pajtohem që denimi me burg dhe me gjobë të më zëvendësohet me Urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

I pandehuri [REDACTED] rreth pranimit të fajësisë deklarojë se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se kjo kishte ndodhur sepse ka qenë i mshës shumë të re dhe gjendja shumë e varfër e tij, tani është penduar për veprimin që e ka bërë dhe kërkon falje, gjithashtu kërkon nga gjykata që të i shqiptojë një sanksion penal më të butë dhe premtion se më nuk do të përsërit vepra të tilla apo te ngjashme penale.

Prokurori i shtetit Valdet Avdiu, duke paraqitur mendimin e tij rreth pranimit të fajësisë deklarojë se e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarve pasi një pranim i tillë nga ana e tyre është bërë vullnetarisht dhe të njëjtit i kanë kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë i cili është ne pajtim me nenin 248 të KPRK-së, mbështetet në provat siq janë: Vërtetimi për sekuestrimin dhe kthimin e sensdeve nga ana e policisë dt.24.04.2015, 27.04.2015, 08.03.2016 dhe 20.03.2016, deklaratat e të dëmtuarve dhe fotodokumentacioni i cili është pjesë përbërëse e shkresave të lëndës dhe i propozon gjykatës që të pranojë pranimin e fajësisë nga i akuzuari, të njëjtit e shpallë fajtor dhe të i shqiptojë një sanksion të paraparë me ligj.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuyës, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit të cilat gjinden në shkresat e lëndës, është udhëzuar.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari gjykues, konform nenit 248 par.4 të KPPK-së, është bindur se mjaftueshm janë vërtetuar faktet , nuk ka prova të pa pranueshme të përcaktuara sipas nenit 257 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*).

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në vazhdim vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së, sikurse me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht nga pika I, II, III dhe IV. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, ka aplikuar praktikën gjyqësore me rastin cilësimit të veprave penale për të pandehurin si vepër penale në vazhdim. Kështu, gjykata ka aplikuar edhe dispozitën ligjore të nenit 81 të KPRK-së me të gjitha paragrafet e kësaj dispozite. Vepruar në aspektin objektiv në këtë rast penal përmbushen të gjitha kushtet për ekzisimin e bashkimit real. Sipas dispozitës ligjore të sipërtheksuar nga paragrafi 1-5 të nenit 81 të KPRK-së për tu konsideruar vepër penale në vazhdim duhet përmbushur së paku dy kushte të cilat konsiderohen elemente përbërëse e kësaj veprë penale. Pra, në rastin konkret përmbushen elementet objektive, por

edhe subjektive të veprës penale në vazhdim për pikën I., II., III., dhe IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për faktin se janë :

- dy e më shumë vepra penale,
- veprat penale janë të të njejtit lloj, madje janë kryer edhe në të njejtin vend dhe hapsirë,
- janë kryer nga i njejt person (ndaj të njetit objekt mbrojtës) dhe në fund,
- të gjitha veprat penale janë kryer brenda periudhës së caktuar kohore.

Për ekzistimin e veprës penale të vazhduar është edhe fakti se të gjitha veprat janë kryer ndaj të njejtit objekt, pra në rastin konkret tempullit fetar- xhamisë dhe të dëmtuarit të cilët në at moment kanë qenë duke i kryer ritet fetare, i cili është subjekt pasiv i veprës penale, të cilën e sajojnë veprën penale në vazhdim . Edhe vendi i kryerjes së veprës penale në rastin konkret ka qenë i njejt tempull fetar- xhamia e madhe në Ferizaj dhe kështu për të gjitha pikat e dispozitivit të këtij aktgjykimi nga I-IV për veprën penale të vazhduar kryhet bashkimi real , sepse edhe ashtu të gjitha veprat penale i përkasin të të njejtë natyrë.

Andaj, gjykata duke aplikaur dispozitën ligjore të sipërtheksuar nga paragrafi 1-5 të nenit 81 të KPRK-së për të gjitha pikat e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe ate: për pikën I., II., III., dhe IV., shqiptoi një denim të vetëm siq është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, duke shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, si dhe në shqyrtimin fillestar, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale dhe peshën e saj.

Gjykata, është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Të pandehurin [REDAKTUAR] gjakata e denoi me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 /tre/ Muaj, dhe me gjobë në shumën prej 200 eurove, në mbështetje të nenit 48 par. 1 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burg dhe me gjobë me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet: në punë në dobi të përgjithshme prej 200 orëve, të cilin do ta kryej në afat prej 6 muaj, prej ditës së fillimit të ekzekutimit.

Konform nenit 48 par. 2 të KPRK-së, Shërbimi Sprovues i Kosovës në Prishtinë, cakton llojin e punës që duhet të kryej personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditën, javën që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme shoqërore si dhe mbikëqyrjen e punës në dobi të përgjithshme shoqërore.

Në mbështetje të nenit 48 par. 4 të KPRK-së, nëse personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata do të urdhëroj zbatimin e dënimit të shqiptuar sipas këtij aktgjykimi në përpjesëtim me punën e kryer.

Numri i lëndës: 2018:011546
Datë: 04.06.2018
Numri i dokumentit: 00052577

Të dëmtuarit dhe ate: 1. [redacted] nga Ferizaji, Rruga [redacted] pa nr., 2. [redacted] nga fshati [redacted] Komuna e Vitisë, 3. [redacted] nga Ferizaji, Rruga [redacted] nr. [redacted] 4. [redacted] nga Ferizaji, Rruga [redacted] pa nr., 5. [redacted] nga Ferizaji, Rruga [redacted] pa nr., 6. [redacted] nga Ferizaji, Rruga [redacted] pa nr., 7. [redacted] nga Ferizaji, Rruga [redacted] pa nr., 8. [redacted] nga fshati [redacted] Komuna e Vitisë 9. [redacted] nga fshati [redacted] Komuna e Ferizajt, dhe 10. [redacted] nga Ferizaji, Rruga [redacted] nr. [redacted] për realizimin e kërkesës pasurore juridike, kompensimi i dëmit udhëzohen në kontest civil.

Konform nenit 453 të KPPRK-së, të pandehuri u obligua që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzet/ €, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhun.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ


P.nr.2695/2017 me datë 31.05.2018

Zyrtari ligjor,
Gazmend Bytyqi



Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve,
pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.
Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj

Nga një Kopje e aktgjykimit u dërgohet të dëmtuarve dhe ate: 

- Një Kopje e aktgjykimit i dërgohet PTH-së në Gjiçan.
- Një Kopje e aktgjykimit i dërgohet Shërbimit Sprorues të Kosovës në Prishtinë.